

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zbardhet plagosja e djeshme në kryeqytet. Shpallet në kërkim autori, në pranga edhe i dëmtuari
ADRESA	https://kohajone.com/aktualitet/zbardhet-plagosja-e-djeshme-ne-kryeqytet-identifikohet-d-he-shpallet-ne-kerkim-autori-ne-pranga-edhe-i-demtuari/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 12:09:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 12:00:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b91d135fff3231f1815a0d8e9a963d7ae89009b27c0d1eefd5d0e74df38db1f7
TEKSTI	4216fc7e9e27e86abf7f7601d46f329cb463cbe7bacc8427dfa813460ec3ebe7
PAMJA	942bffffe2b02d905afb2e030652591e2df5bb6f667ca3957ee84660d6b0723

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9e7d8fe559ac17d07b7cecbf11908af6ace187fd8c5e921c404d9751b0986bee
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0248b36ffa7147e2cf97c5d4334b4ac10f1e643fb19828b3303283d4e0ef69ec
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9e7d8fe559ac17d07b7cecbf11908af6ace187fd8c5e921c404d9751b0986bee>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Zbardhet plagosja e djeshme në kryeqytet. Shpallet në kërkim autori, në pranga edhe i dëmtuari

AKTUALITET E SHTUNË, 26 SHTATOR 2026 14:00



Zbardhet brenda 24 orëve, autorësia dhe rrethanat e plagosjes me armë zjarri, të ndodhur dje, në rrugën "Hysni Gërbolli".

Si rezultat i veprimeve të shpejta dhe profesionale hetimore, të kryera nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 3, u bë e mundur zbardhja e rrethanave dhe dokumentimi i ngjarjes së ndodhur më datë 25.09.2026, në rrugën "Hysni Gërbolli".



Nga veprimet hetimore dyshohet se, gjatë një konflikti në një lokal, shtetasi S. P., 54 vjeç, ka qëlluar me armë zjarri dhe ka plagosur në këmbë shtetasin Gj. K., 33 vjeç, dhe më pas është larguar nga vendngjarja.

54-vjeçari, u shpall në kërkim për veprat penale "Vrasja e mbetur në tentativë", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit", "Mbajtja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Prishja e qetësisë dhe rendit publik", ndërsa vijon puna për lokalizimin dhe kapjen e tij.

Gjatë kontrollit në banesën e shtetasit S. P., u gjetën dhe u sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë gjahu, një mjet prerës (thikë) dhe municion luftarak.

Në vijim të veprimeve hetimore, rezultoi se gjatë konfliktit ishte përfshirë edhe shtetasi S. T., 20 vjeç, i cili dyshohet se është konfliktuar me disa persona me sende të forta, duke mbetur i dëmtuar shtetasi A. P., 18 vjeç. Në përfundim të veprimeve procedurale, shtetasi S. T. u arrestua në flagrancë për veprat penale "Plagosja e lehtë me dashje", "Moskallëzimi i kimit" dhe "Prishja e qetësisë dhe rendit publik".

Ndërkohë, nisi procedimi penal në gjendje të lirë për shtetasit B. P., 49 vjeç, dhe S. P., 18 vjeç, pasi dyshohet se gjatë konfliktit kanë goditur me sende të forta shtetasin S. T. Gjithashtu, gjatë kontrollit në banesën e 49-vjeçarit u gjetën dhe u sekuestruan disa fishekë.

Në vijim, gjatë verifikimeve të kryera, rezultoi se shtetasi Gj. K., 33 vjeç, ishte person në kërkim nga autoritetet e Kosovës. 33-vjeçari u arrestua me qëllim ekstradimi, pasi rezultoi i dënuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë me 50 ditë burgim, për veprën penale "Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge".

LAJMET KRYESORE



SPAK aksion në Shkodër e Tiranë! Arrestohet një person, Endrit Dokle sërisht në kërkim



Eric Wendt, mundësia për të lënë një gjurmë të veçantë në Shqipëri



Bypass-i i Shëngjinit mbaron në mars 2027



Rama në OKB: Protesta në Tiranë u ngrit mbi "fantazmën" e pushtimit izraelit. Duhet një marrëveshje ndërkombëtare për IA



Rama nga New Yorku: Nuk më ndalin me baltë dhe jargë, Shqipërinë do ta çoj në majën e Europës së Bashkuar

TË PËRZGJEDHURA



David Beckham merr 39 milionë paund dividend, marrëveshjet e Kupës së Botës nxisin fitime rekord



Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hijet Balluku-lokomotivë shtetfo...



Sukses i menjëhershëm për Muse të Metës: Mjeti i AI tejkalon rivalët si ChatGPT dhe Claude



Inteligjenca artificiale mund të jetë më e rrezikshme se bomba atomike. Robotët e vitëve 2030, 2040, 2...



Hamilton mohon kategorikisht: "S'kam kërkuar ndryshime stafi te Ferrari"

MË TË LEXUARAT

MË SHUMË NGA AKTUALITETI

**Shembet ndërtesa në Athinë/
Tre nga të zhdukurit janë
shqiptarë, ende...**



**Faza e re e rindërtimit në
Kombinat, Bashkia e Tiranës
vijon heqjen e...**

**Nesër maratona e Tiranës, ja
rrugët që do të bllokohen dhe
linjat urb...**



**Në kërkim si pjesë e një
organizate kriminale, arrestohet
53-vjeçari ...**

**Reshjet e para të borës
zbardhin Bjeshkët e Tropojës**



**SPAK aksion në Shkodër e
Tiranë! Arrestohet një person,
Endrit Dokle ...**

LAJMET E FUNDIT



**Singapori paguan qytetarët për
të lexuar: 15 minuta në ditë në
këmbim të parave**

[1 MINUTË MË PARË](#)



**Zbardhet plagosja e djeshme
në kryeqytet. Shpallet në
kërkim autori, në pranga edhe i
dëmtuari**

[6 MINUTA MË PARË](#)

**Shembet ndërtesa në Athinë/
Tre nga të zhdukurit janë
shqiptarë, ende nën rrënoja**

[11 MINUTA MË PARË](#)




**Nesër maratona e Tiranës, ja
rrugët që do të bllokohen dhe
linjat urbane që devijohen**

[51 MINUTA MË PARË](#)

**Berisha: Vlorë Hyseni është
kthyer për t'u dhënë reston
bashkëpunëtorëve që e
tradhtuan**

[1 ORË E 3 MINUTA MË PARË](#)



**Eric Wendt shkon në Pallatin e
Brigadave, takim me
Presidentin Begaj**

[1 ORË E 30 MINUTA MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONË

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frashëri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

RAJONI

KOSOVA

BOTA

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHYLLA



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C

S)

© 2024 KOHA JONE. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.